



8/41-V2

Rregullore

Maj/2020

**RREGULLORE
PËR VLERËSIM TË STUDENTËVE**

PRISHTINË, Maj 2020

Mbështetur në dispozitat relevante të LIGJIT Nr. 04/L-037 PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, dhe dispozitës së nenit 88 të Statutit të BPrAL Kolegji UBT, Presidenti i këtij Kolegji, në mbledhjen mbajtur në Prishtinë më datën **15.05. 2019**, kanë miratuar këtë:

RREGULLORE PËR VLERËSIM TË STUDENTËVE

I. VLERËSIMI I PUNIMEVE DHE NOTIMI I STUDENTËVE

Neni 1.

Punimet e studentëve në lëndë përcjellën, vlerëson dhe notohet individualisht, dhe ne raport me grupin ose gjeneratën - si gjatë ligjëratave po ashtu edhe gjatë gjithë programit studimor.

Vlerësimi dhe notimi i studentëve behet me aplikimin e sistemit evropian të bartjes se pikëve (ECTS).

ECTS pikët për lëndë i përshkruhet secilës lëndë mbi bazën e planeve dhe programeve te dy (2) kriterëve, dhe atë:

- **angazhimi punues i studentit, si dhe**
- **vlera e lëndës për kompeticimin e profesionit ose degës.**

Neni 2.

Ngarkesa punuese e studentit nga të gjitha bazat është nga 1 ECTS poen deri 30 orë për semestër, ashtu qe numri i ECTS poenëve mund të korrigjohen varësisht nga kontributi me i vogël ose me i madh i profilit të lëndë.

Mbi te gjitha bazat ngarkesa e studentit nga 3 deri 8 ECTS poenë, janë:

Nr. Ren.	Lloji i ngarkesave	3 deri 4 ECTS	nga 5 deri 6 ECTS	nga 7 deri 8 ECTS
1.	Ligjëratat	20	30	30
2.	Seminaret e përbashkëta dhe ushtrimet	10	15	30
3.	Puna kolektive	8	10	15
4.	Mësimi i pavarur nga literatura obligative	30	30	30
5.	Konsultimi i literaturës plotësuese	12	20	20
6.	Punimi i seminareve	10	10	15
7.	Mbrojtja e punimeve seminare	1	1	1
8.	Punimi, prezantimi dhe arsyetimi i detyrave shtëpiakë	5	8	10
9.	Punimi dhe mbrojtja e rastit studimore	4	6	9

10.	Përgatitjet për kolokvium ose forma tjera të provimeve periodike	10	10	10
11.	Hulumtimet e burimeve tjera	10	10	10
Ngarkesa e tërësishme punuese e studentit shndërruar ne numër orësh		120	150	180

II. VLERËSIMI NË KUADËR TË RREGULLATIVËS EVROPIANE TË BARTJES SE POENAVE

Forma e vlerësimit individual

Neni 3.

Suksesi i studentit për secilën lëndë shprehet në ECTS vlerësim në përqindje nga 0 deri 100%, si dhe vlerësimin përfundimtar poenësh konformë Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë (notat 6 deri 10).

Kalueshmëria në përqindje nga 50% deri 100%, me nota numerike 6 (mjaftueshëm) deri 10 (shkëlqyeshëm).

Nota përfundimtare nga lënda është mbledhja e përqindjeve të suksesit të studentit gjatë ligjëratave dhe përqindjeve të suksesit të tij sendërtuar në provim përfundimtar.

Mënyra e notimit gjatë ligjëratave

Neni 4.

Përcjellja dhe vlerësimi i studentit për secilën lëndë behet gjatë ligjëratave mbi bazën e elementeve, si ne vazhdim:

- **prezencës ne ligjëratë,**
- **angazhimit dhe aktiviteteteve ne ligjëratë, seminare dhe ushtrime,**
- **numrit të ushtrimeve dhe detyrave,**
- **zgjidhjeve të rastit,**
- **suksesit ne kolokviume ose provimeve parciale,**
- **elemente tjera qe ka vërtetuar mësime dhënësi ne përshkrimin e lëndës së tij.**

Neni 5.

Nëse suksesi i studentit gjatë ligjëratës është maksimalisht dhe kështu sendërton edhe nota të mira nga kolokviumi ose provime parciale, mësime dhënësi mund t'ia mbylli notën edhe pa dhënien e provimit përfundimtar nga ajo lëndë, sipas kushteve qe mësime dhënësi i ka shënuar në Sillabusin e tij.

Provimi përfundimtar nga lënda:

Neni 6.

Provimi përfundimtar nga cilado lëndë epet pas përfundimit të ligjëratave, vërtetimit të suksesit gjatë ligjëratave dhe marrjes së nënshkrimit nga mësimdhënësi, dhe bënë 30% deri 40% të notës përfundimtare nga lënda.

Provimi përfundimtar nga lënda mund të jetë me shkrim (testimi) ose edhe me shkrim edhe me gojë.

Pjesa e provimit me gojë nuk është e domosdoshme të zbatohet nëse gjatë ligjëratës ka pasur shumë aktivitete në pikëpamjeve të shpjegimeve gojore, prezantimeve, diskutimeve etj., dhe nëse mësimdhënësi këto i ka paraparë në SYLABUS.

Mënyra e dhënies së provimit përfundimtar në afate paraparë me plan program mësimor, numrin e daljeve, dhëniet e provimeve para komisionit arsimtarësh, etj., rregullohet me STATUT dhe RREGULLOREN PËR STUDIME të BPrAL Kolegji UBT.

III. RREGULLAT E SJELLJES SE STUDENTIT NE PROVIM PËRFUNDIMTAR NGA LËNDA

Neni 7.

Daljen në provim me shkrim përfundimtar studenti është i obliguar ta paraqes në FLETËPARAQITJE adekuate, duke ja dorëzuar referentit për çështje studentore, në mënyrën dhe brenda afateve paraparë më RREGULLORE PËR STUDIME të BPrAL Kolegji UBT.

Gjatë kohëzgjatjes së provimit me shkrim nuk lejohet:

- **kopjimet, bisedimet ose kthimet e lëvizjeve trupore para - anash apo prapa,**
- **te ketë telefonin mobil të kyçur,**
- **dorëzimi i paskohëshëm të testit ose punës me shkrim pasi që mësimdhënësi ka sinjalizuar se koha për përshkrim ka kaluar, si dhe dorëzimi i punës me shkrim të behet ashtu që të jetë i kthyer nga faqja ku shihet dukshëm emri dhe mbiemri i studentit dhe numri amë i tij.**

Në të gjitha rastet e ndodhive të sipërme, mësimdhënësi i lëndës nuk do ta shqyrtoi fare provimin me shkrim, dhe studenti do të vlerësohet me zero (0) poen në provimin përfundimtar të lëndës.

Pas kalimit të afatit për përshkrim të provimit me shkrim, studentit nuk i lejohet më kurrfarë përmirësimesh në test apo punë me shkrim.

IV. RREGULLAT E SJELLJEVE TË STUDENTËVE NË PROVIMIN PËRFUNDIMTAR ME GOJË NGA LËNDA

Neni 8.

Dalja në provim me gojë nga lënda mund të jetë detyrues sipas orarit që ka publikuar mësimdhënësi.

Gjatë kohëzgjatjes së provimit me gojë nga lënda, nuk është e lejuar:

- kopjimi, bisedimi ose cilado formë tjetër e komunikimit jo verbal ndërmjet të pranishmeve,
- leximi i çfarëdo forme të skripteve ose formave tjera sugjestive për pyetjet e shtruara,
- te ketë telefonin mobil të kyçur ose çfarëdo emetuesi tjetër informatash.

V. BARAZIMI I NOTIMIT ME ECTS VLERËSIMIN

Neni 9.

Notat e suksesit krahasohen me ETCS vlerësimin, si ne vazhdim:

- | | | |
|-------------------------------------|---------------------------------|------------------|
| - nota 10 (shembullor) | i përgjigjet vlerësimit A | të nivelit ECTS, |
| - nota 9 (shkëlqyeshëm) | i përgjigjet vlerësimit B | të nivelit ECTS, |
| - nota 8 (shumë mirë) | i përgjigjet vlerësimit C | të nivelit ECTS, |
| - nota 7 dhe 6 (mirë & mjaftueshëm) | i përgjigjet vlerësimit D dhe E | të nivelit ECTS. |

VI. DETYRIMET E BARTËSIT TË LËNDËS

Neni 10.

Bartësi i lëndës (MENTORI) tek mësimi ne ligjërata individuale është i obliguar qe te udhëhiqi evidencën e secilit student mbi arritjen e suksesit ne përqindje (%), dhe dijës për secilin segment të notimit si dhe përqindjes (%) përfundimtare të provimit.

Bartësi i lëndës është gjithashtu i obliguar qe me kërkesën e studentit ti mundësoi shikimin ne përqindje (%) të suksesit për secilin segment vlerësimi.

Bartësi i lëndës është i obliguar te vlerësoi studentin me përqindje (%) të ECTS në shkallën 0 deri 100% notim dhe notim numerik.

Pas kryerjes së vlerësimit të te studentit gjatë ligjëratave dhe përfundimit të provimit, bartësi i lëndës është i detyruar të saktësoi përqindjen (%) e përgjithshme të notimit për secilin student nga grupimi dhe të formoj Listën Përfundimtare sipas rezultateve të përqindjes (%) së notave.

Ne rast se numri i studentëve nuk mund të renditjes sipas përqindjes (%) së njëjtë vlerësimi përfundimtar, përparësi në renditje do të ketë studenti i cili ka realizuar me shumë përqindje (%) në provimin përfundimtar, dhe pastaj studenti i cili ka realizuar numër më të lartë përqindjeje (%) të vlerësimeve arritur në kolokviume.

Bartësi i lëndës është i obliguar qe studentet ti njoftoi lidhur me metodën e nxjerrës së vlerësimeve në parametra të përqindjes (%) për të gjitha llojet e verifikimeve të dijës se arritur, suksesit dhe kompetencionit - si dhe formave të përpilimit të notës përfundimtare.

VII. SUKSESI PËRFUNDIMTAR PAS PËRFUNDIMIT TË PROGRAMEVE

Neni 11.

Mbi bazën e përqindjeve (%) mesatare të te gjitha provimeve dhe diplomës, përcaktohet klasifikimi përfundimtar (e ashtuquajtur: klasifikimi i nderit), në formën si më poshtë:

- **klasa e parë (First Class Honours) 80 deri 100% arritjes se dijës, shkadhesave dhe kompetencionit,**

- klasa e dytë e lartë (Upper Second Class Honours) 70 deri 79% arritjes se dijës, shkadhesave dhe kompetencionit,
- klasa e dytë e poshtme (Lower Second Class Honours) 60 deri 69% arritjes se dijës, shkadhesave dhe kompetencionit,
- klasa e tretë (Third Class Honours) 50 deri 59% arritjes se dijës, shkadhesave dhe kompetencionit,
- kaloi provimin (Pass) 40 deri 49% arritjes se dijës, shkadhesave dhe kompetencionit.

Studentëve me përqindje (%) përfundimtare të mesatares të mësim nxënies, shkathtësive dhe kompetencionit me përfundimin e studimeve në dëftesë, respektivisht, diplomë, përshkruhet falënderimi nga gjuha latine e klasifikimeve të falënderimeve:

- renditja e parë me falënderim me të lartë (SUMMA CUM LAUDE Baccalaureus), gjegjësisht, specialist me falënderimin me të lartë (SUMMA CUM LAUDE Specijalist),
- renditja e parë me falënderim të madh (MAGNA CUM LAUDE Baccalaureus), gjegjësisht, specialist me falënderim të madh (MAGNA CUM LAUDE Specijalist),
- renditja e parë me falënderim (CUM LAUDE Baccalaureus), gjegjësisht, specialist me falënderim (CUM LAUDE Specijalist).

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 12.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje merren ne procedurë të njëjtë si dhe vetë Rregullorja.

Neni 13.

Kjo Rregullore hynë në fuqi tetë (8) ditë pas nënshkrimit të sajë, si dhe publikimit të saj.

PRISHTINË,

Datë, 15.05.2019

**BPrAL Kolegji UBT
PRESIDENTI -
Prof. Dr. Edmond HAJRIZI**
